



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:045553

Datë: 29.11.2023

Numri i dokumentit: 04983207

PS.nr.58/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / Departamenti Special, kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Vesel Ismaili dhe anëtarët Vjoleta Namani Hajra dhe Suzana Çerkini, me bashkëpunëtoren profesionale Rovena Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit G.H., për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par 2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK) i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.34/2021, të datës 30.12.2022, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e Marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të datës 13.11.2023, në prezencën e Prokurorit të PSRK-së Ilir Morina, të pandehurit G.H., me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.F. B., me datë 14.11.2023, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

G.H., nga babai G., e ëma Xh., mbiemri i vajzërisë E., i lindur më 17.05.1993, në fshatin T., komuna D., tani me vendbanim në F. K., rruga E. M., pa nr, student, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Nga data 01 janar 2021 deri me datë 10 mars 2021, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) në Fushë Kosovë, me dashje dhe në bashkëkryerje me persona të tjerë të pa identifikuar, të pandehurit A.K., S.M., I.H., G.H. në cilësinë e personave zyrtarë - punonjës në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në marrëveshje paraprake me të pandehurin P.P., i falsifikojnë rezultatet e votimit të Zgjedhjeve të Përgjithshme të Parakohshme Parlamentare për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura me 14 shkurt 2021, me qëllim të shtimit të votave për kandidaten M.H.S., nga radhët e subjektit politik "AAK", në atë mënyrë që, gjatë procesit të numërimit të votave me kusht dhe me postë, i shtojnë 65 vota për kandidaten H.-S. dhe atë në tavolinat e identifikuar me numrat: CB 103/003, CB 104/005, CB 106/003, CBI 17/005, CBI 18/006, CB 119/009, CB 127/001, BM 106/002, kurse me datë 02 mars 2021 të pandehurit S.M. dhe A.K., takohen me dëshmitarin J.B. i cili ishte bashkëshorti i kandidates për deputete nga radhët e subjektit politik "AAK" znj. A.B. dhe gjatë diskutimit i tregojnë dëshmitarit se i kanë falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve duke i shtuar vota kandidates M.H.S., ndërsa

dëshmitari B. e kishte incizuar këtë komunikim dhe e kishte publikuar në portalin online "Insajderi", me ç'rast gjatë kontrollit të kryer nga zyrtarët e KQZ dhe hetuesit e policisë QNR të KQZ-së u rinumëruan votat e këtij subjekti politik dhe u konstatua se kandidatet M.H.S. i ishin shtuar 65 vota, në tavolinat në të cilat të pandehurit S.M., A.K., I.H. dhe G.H., ishin angazhuar si numërues të pandehurit kurse pas publikimit të audio incizimit në media, i pandehuri P.P. e thërret të pandehurin I.H. përmes aplikacionit "Viber" dhe zhvillojnë bisedë lidhur me shtimin e votave për kandidaten H. S. dhe për arrestimin e të pandehurve S.M. e A.K., ku mes tjerash i thotë *"a u kthyen në realitet"* ndërsa Ilirjani i përgjigjet se *"po janë kthyer në realitet qysh kanë qenë, domethënë na i kanë hjek neve ato që i kemi bo na...po ata djemtë e kjo çika po ju them rrinë qetë, jam duke punuar me ta që mos të flasin"*, ndërsa P.P. ia kthen *"llug, qata tre të incizimit i kish marr sot në prokurori, kqyr fshij çka ke fol, me kon ke fol, qoje telefonin formatizoje dhe fshij të gjitha senet se unë e kam formatizuar"*, tutje I. i premtun se *"këta tjerët thash po rrinë qetë e po besoj që nëse thirrin ose diçka normal që se pranojnë, e njëri që po tutet ma fort nëse muj mu marr unë pak me të, me mujt me qetësu, që thjesht mos të pranon edhe në rregull është"*, ndërsa P. i kërkon I. se *"kjo çka ka ndodh duhet me këput zingjirin dikun, a pe dinë, në qoftë shkon ma nalt veç kemi mu blloku krejt, a në qoftë se rrinë ma poshtë kem fuqi me ju ndihmu a pe din. Me bo me shku ma nalt tani veç duhet mu dorëzu krejt, qa bahet le të bahet, a kështu që sbon me ardh puna deri te unë ose deri te ti"*

- Me këtë në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par 2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit penal të Republikës së Kosovës

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 6, 7, 17, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 59, 62, të KPRK-së, si dhe neneve 230, 358, 359 dhe 364 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit i:

SHQIPTON

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri gjate periudhës kohore prej dymbëdhjetë (12) muaj nuk kryen vepër tjetër penale;

Dënim plotësues ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratë publike ose në shërbime publike gjatë periudhës kohore prej dymbëdhjetë (12) muaj nga plotfuqishmëria e aktgjykimit;

Obligohet i pandehuri që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe atë; në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) dhe për fondin e viktimave të krimit shumën prej 100€ (njëqind euro), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzën PPS.nr.34/2021, të datës 30.12.2022, kundër të pandehurve A.K., S.M., P.P., I.H., dhe G.H., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultatit të votimit nga neni 216 par. 2 lidhur me par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Haxhi Shala S.M. dhe D. G., për shkak të veprës penale në

bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të nga neni 216 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale, me datën 16.03.2023, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Menjëherë pas leximit të aktakuzës, gjykata pyet të pandehurit se a e kanë kuptuar dhe a kanë nevojë për sqarime shtesë, duke i' u dhënë mundësinë që të deklarohen në lidhje me fajësinë, ku të pandehurit deklarohen se nuk ndjehen fajtor për veprën penale që i' u vihet në barrë, sipas aktakuzës, ndërsa me datën 11.07.2023 është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë në mes të Prokurorit të Shtetit dhe të pandehurit G.H. e cila edhe i është dorëzuar gjykatës.

Me datë 13.11.2023, Kryetari i trupit gjykues ka caktuar dhe ka mbajtur seancë e shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë prezantuar Prokurori i Shtetit i PSRK-së Ilir Morina, përfaqësuesja e KQZ-së F. B., i pandehuri A.K. me mbrojtësit e tij av.S. M., **S.M.** me mbrojtësin av. D. M., **P.P.** me mbrojtësin av.H. Sh., **I.H.** me mbrojtësin e tij av.I. B., **G.H.** me mbrojtësin e tij av.Flamur Bllacaku, **Haxhi Shala** me mbrojtësin e tij av.Xhevdet Smakiqi, ndërsa nuk ka prezantuar i pandehuri **Dardan Gashi** për të cilin mbrojtësja e tij av.Sahadete Gashi e njofton gjykatën se i njëjti e ka babain e sëmure në gjendje kritike dhe për këtë arsye nuk ka mund të jetë prezent në seancën e shqyrtimit gjyqësor, po ashtu në seancë kanë prezantuar dëshmitaret M.H. dhe F. M.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor, në pajtim me dispozitat e nenit 230 dhe 241 paragrafi 5 të KPPRK, ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të lidhur në mes të prokurorit të shtetit dhe të pandehurit G.H. ashtu që ka dëgjuar Prokurorin e PSRK-së Ilir Morina, të pandehurin G.H. me mbrojtësit e tij sipas autorizimit av.F. B..

Prokurori i Prokurorisë Speciale Ilir Morina gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes për pranim të fajësisë dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta pranoj ashtu siç është lidhura në mes të prokurorisë, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij e të cilën marrëveshje e ka elaboruar.

Me të pandehurin G.H. prokurori i PSRK, me datë 11.07.2023 ka lidhur marrëveshje për pranim të fajësisë për veprën penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultatit të votimit nga neni 216 par. 2 lidhur me par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe i ka rekomanduar Gjykatës që ta gjykojë me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri gjate periudhës kohore prej dymbëdhjetë (12) muaj nuk kryen vepër tjetër penale si dhe me dënim plotësues Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratë publike ose në shërbime publike gjatë periudhës kohore prej dymbëdhjetë (12) muaj nga plotfuqishmëria e aktgjykimit,

Mbrojtësi i të pandehurit G.H., av. F. B. gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se në konsultime të mjaftueshme me të mbrojturin tim G. dhe i njëjti me vullnet të plotë duke qenë i njoftuar me të gjitha privilegjet dhe detyrimet që i ka dhe që do ti merr nga ana e pranimit të fajësisë i njëjti me vetëdije dhe me vullnet të plotë e pranon fajësinë, me ç'rast kemi bërë një marrëveshje me shkrim në prokurori përmes së cilës janë cekur

dhe evidentuar si lloj i dënimit dhe dënimi prandaj ne e pranojmë këtë marrëveshje dhe kërkojmë nga ana e gjykatës që ta aprovojë si të tillë, pasi që e njëjta është konform dispozitave ligjore. I mbrojturi im para hyrjes në marrëveshje për pranim të fajësisë është qartësuar edhe për klasifikimin juridik të veprës penale për të cilën ngarkohet në bashkëkryerje, por me këtë klasifikim të veprës penale ka pranuar të hyj në marrëveshje mbi pranim fajësinë gjegjësisht e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën ngarkohet duke pranuar në bazë të rekomandimit numër dy, dënimin e rekomanduar.

I pandehuri G.H. ka deklaruar se pajtohet me thëniet e mbrojtësit të tij se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin tim av..F. B., dhe pasi që i njëjti mi sqaroi pasojat dhe benifitet për hyrjen në marrëveshje mbi pranim fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, unë me vetëdije të plotë dhe me vullnet pa imponime, pa ndikime, pa kanosje nga askush kam pranuar që të hyjë në marrëveshje me PSRK-në, për pranimin e fajësisë për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës dhe pajtohet me dënimin e rekomanduar nga PSRK.

Gjykata pas shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr. 34/2021, të datës 11.07.2023, e cila ka të bëjë me të pandehurin G.H. për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par 2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit penal të Republikës së Kosovës si dhe deklarimet për pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri në pajtim me dispozitat e nenit 230 par. 17 të KPP-së, gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se i pandehuri ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet me aktakuzë dhe atë duke u bazuar në pranimin e fajësisë nga vetë i pandehuri dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe si dhe në provat tjera të cilat i përmban aktakuza të cilat prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë, ku gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 248 par.1 të KPP-së, për pushimin e procedurës përkatësisht hudhjen e aktakuzës, prandaj gjykata ka konstatuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe bazuar në nenin 230 par.20 të KPP-së të njëjtën e ka pranuar dhe ka vendosur në shkresat e lëndës.

Prandaj, gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e veprave penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke gjetur se me të vërtetë i pandehuri ka kryer veprat penale ashtu siç përshkruhen në aktakuzë dhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe për këtë ka vendosur që të pandehurit ta shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata i dëgjoji deklaratat e palëve dhe ka pranuar dënimet e propozuar sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ashtu që gjykata i ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, andaj gjykata vlerëson se me dënimet e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, dhe se dënimet e tilla të shqiptuar sipas

marrëveshjes për pranimin e fajësisë janë në proporcion me veprat e kryera penale dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i pandehuri.

Gjykata në kuptim të nenit 35 par. 1 dhe par. 2 të KPPRK-së pasi që bëri pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit G.H., për shkaqe të ekonomizimit dhe efikasitetit ndaj të njëjtit e veçoi procedurën penale për të formuar lëndë e re sipas marrëveshjes për pranim të fajësisë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 451 të KPP-së ndërsa lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 36 par 3, pika 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 08/L-109).

Vendimi për mos lejimin e afatit për ankesë është marrë duke u bazuar në nenin 485, par.2, ku potencon se *“në qoftë se nuk është parashtruar ankesë ose palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë”*, e në rastin konkret palët gje gjësisht PSRK dhe i pandehuri me mbrojtësin e tij, në marrëveshjen për pranimin e fajësisë kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës, gjykata nuk ka lënë afat ankesë dhe ky aktgjykim bëhet i plotfuqishëm menjëherë pas pranimit të tij nga ana e palëve.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi, e në mbështetje të neneve 230, 358, 364 dhe 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti Special

PS.nr.58/2023, i datës 14.11.2023

Bashkëpunëtorë Profesionale,
Rovena Kastrati

Kryetari i trupit gjykues- Gjyqtari,
Vesel Ismaili

UDHËZIMI JURIDIK:

Pasi që palët kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës, aktgjykim i bëhet i plotfuqishëm në momentin e pranimit të tij nga ana e tyre.